



RAPORT MONITORIMI: ZBATIMI I AKSESUESHMËRISË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ky raport u mundësua me ndihmën e Popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk reflektojnë pikëpamjet e USAID ose të Qeverisë së Shteteve të bashkuara.

This report is made possible by the support of the American People through the United States Agency for International Development (USAID.) The contents of this report are the sole responsibility of Albanian Disability Rights Foundation and do not necessarily reflect the views of USAID or the United States Government.

PASQYRA E LËNDËS

LISTA E SHKURTIMEVE.....

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....

I. HYRJE.....

II. METODOLOGJIA.....

III. VLERËSIME TEORIKE MBI AKSESUESHMËRINË.....

IV. VLERËSIM I KUADRIT LIGJOR DHE POLITIK MBI AKSESUESHMËRINË.....

I. 1 Gjendja e aksesueshmërisë në Shqipëri sipas raporteve kombëtare

I. 2 Përmbledhje e kuadrit ligjor ndërkombëtar mbi aksesueshmërinë

I.3 Kuadri ligjor kombëtar

I.4 Vendimit të Këshillit të Ministrave Numër nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

V. NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE „PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR MËNJANIMIN E PENGESAVE NË KOMUNIKIM DHE INFRASTRUKTURË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA“.....

V. 1 Zbatueshmëria nga institucionet e përfshira

V. 2 Zbatueshmëria nga institucionet qendrore

V. 3 Personat me aftësi të kufizuara dhe aksesueshmëria

VI. REKOMANDIME & KONKLUZIONE.....

REFERENCA.....

LISTA E SHKURTIMEVE

ANAD	Shoqata Kombëtare e Personave që nuk Dëgjojnë
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHPSHSH	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
KKAK	Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MB	Ministria e Punëve të Brendshme
MMSR	Ministri e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
PAK	Person me Aftësi të Kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Masat për sigurimin aksesueshmërisë

Grafiku 2. Përqindja e institucioneve që nuk sigurojnë aksesueshmërinë

Grafiku 3. Institucionet që ofrojnë formatet të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara të ndryshme

Grafiku 4 .Institucionet që njohin VKM-në Nr. 1074

Grafiku 5. Arsyet e mossigurimit të aksesueshmërisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Objektivi kryesor i këtij raporti është që të evidentojë nivelin e njohjes e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Numër 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.¹

Ky raport monitorimi ka si objektivi të dytë ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore dhe private në lidhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar të pranuar nga Shqipëria për garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara dhe në mënyrë të veçantë me detyrimet, përgjegjësitë dhe rolin që ata në kanë në zbatimin e VKM-së Nr. 1074 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

Raporti është i pari i këtij lloji në Shqipëri. Ai merr shkas nga hovi i madh i legjislacionit shqiptar, duke prodhuar vitet e fundit një mori ligjesh dhe vendimesh² pas ratifikimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), me qëllim garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Duke parë sfidat e përditshme që hasin të gjithë aktorët kryesorë, publikë dhe privat, shoqëria dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, ky monitorim shërben për të evidentuar nivelin e njohurive dhe të zbatimit, problemet kryesore, prioritizimin e ndërhyrjeve të mundshme dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me detyrimet dhe përgjegjësitë konkrete që ato kanë në zbatim të VKM-së Nr. 1074. Ky raport monitorimi do të shërbejë edhe si një mjet zhvillimi, duke dhënë informacion mbi progresin e bërë në një periudhë të caktuar kohe.

Në zbatim të dy objektivave të vendosura, raporti ka ndjekur dy linja kryesore monitorimi:

Së pari, është realizuar një vlerësim i kuadrin ligjor dhe politik, kombëtar e ndërkombëtar.

Së dyti, është monitoruar niveli i njohjes nga institucionet e VKM-së Nr. 1074 dhe niveli i zbatimit të këtij vendimi.

Pas shqyrtimit të kuadrin ligjor kombëtar rezulton që ka një nivel të kënaqshëm të përputhshmërisë së tij me standardet ndërkombëtare, me fokusin në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/243.pdf

² Ligjet dhe vendimet janë përfshirë në kapitullin VLERËSIM I KUADRIT LIGJOR DHE POLITIK MBI AKSESUESHMËRINË.

Institucionet tashmë janë të ndërgjegjësuar për detyrimet që ato kanë për sigurimin e aksesueshmërisë dhe kanë ndërmarrë disa hapa për sigurimin e saj, pavarësisht se njohin në mënyrë të pjesshme dhe sipërfaqësore kuadrin ligjor. Atyre i mungojnë njohuritë mbi ligjet e vendimet e miratuara rishtazi, por dhe njohuritë teknike, burimet njerëzore e financiare për t'i zbatuar ato.

Megjithatë, përtej hartimit të legjislacionit sipas standardeve ndërkombëtare dhe nivelit të ndërgjegjësimit të institucioneve, nuk janë jetësuar akoma mekanizmat monitorues dhe ankimues të tij. Kuadri ligjor aktualisht përcakton institucionet monitoruese por këto institucione akoma nuk kanë ndërmarrë hapa në drejtim të monitorimit, por as të nxitjes të zbatimit të legjislacionit.

Detyrimet që i janë vendosur në VKM-në Nr. 1074³ institucioneve përgjegjëse nuk janë realizuar nga pjesa dërmuese e tyre. Kjo VKM nuk njihet nga pjesa më e madhe e institucioneve.

Niveli ulët i zbatimit vjen për disa arsye, (a) Miratimi i ligjeve dhe vendimeve nuk është shoqëruar me fushata promovimi dhe me aktivitete trajnimesh të dmosdoshme për zbatimin efektiv të legjislacionit; (b) Nga ana tjetër përfshirja e vetë komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në diskutimin e çështjeve të aksesueshmërisë, gjë që do të ndihmonte në përmirësimin e saj është e ulët; (c) Nuk ka një bashkëpunim të mirë dhe shkëmbim ekspertize në këtë drejtim; (d) Gjithashtu si arsye kryesore vetë institucionet rendisin mungesën e burimeve financiare dhe njerëzore e mungesën e koordinimit mes tyre, në nivel qendror dhe vendor.

Nga monitorimi rezultoi që vetëm në një rast ishte zbatuar detyrimi për hartimin dhe miratimin e planit të masave për mënjanimin e pengesave nga institucionet.

I. HYRJE

Vitet e fundit flitet gjithnjë e më shumë për koncepte të tilla si akses, aksesueshmëria, dizenjimi universal, përfshirja, përshtatshmëria, akomodimi e të tjera koncepte të ngjashme. Këto janë terma që shpeshherë përdoren me të njëjtin kuptim.

Ndërkohë që vihen re disa ndryshime ose përmirësime në fushën e ndërtimit, arkitekturës në ambjentet fizike apo në fushën e teknologjisë së informacionit, shumë pak është bërë në fushat e tjera, si për shembull në fushën e shërbimeve. Është shumë e rëndësishme që të gjithë pjestarët e shoqërisë në tërësi, pavarësisht aftësive apo moshës që kanë, të kenë akses në të gjitha produktet dhe shërbimet që ofrohen për ta. Çështjet e aksesueshmërisë kanë marrë një rëndësi themelore duke pasur parasysh që nevojat e grupeve në rritje janë diversifikuar,

³ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/243.pdf

me grupe si personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, personat në moshë të tretë, ata me aftësi të kufizuara të përkohëshme për shkak të sëmundjeve apo gjendjeve shëndetësore të caktuara. Bazuar pikërisht në këto kufizime, nevojat për aksesueshmëri janë të ndryshme. Prandaj ka lindur me kohë nevoja për të adresuar nevojat specifike të këtyre grupeve të veçanta përmes krijimit të standardeve universale.⁴ Në thelb, aksesueshmëria kërkon që dizenjimi i produkteve, sistemeve apo shërbimeve të jenë të atilla që të përdoren nga një grup sa më i madh njëzësh. Shpeshherë në mënyrë të ngjashme përdoret dhe koncepti i dizenjimit universal, i cili në thelb ka të njëjtat kërkesa, dizenjimin në një mënyrë të tillë që të përdoren nga të gjithë, pa pasur nevojë për ndërhyrje apo modifikime të tjera të nevojshme për grupe të veçanta. Duhet theksuar që një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e aksesueshmërisë ka pasur hartimi legjislativ të posaçëm kundër diskriminimit.⁵

Sikurse do të sqarohet në kapitujt vijues, në mënyrë më të detajuar, mungesa e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara shihet gjithmonë nga perspektiva e diskriminimit, pra mungesa e sigurimit të aksesueshmërisë diskriminon personat me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të gjitha të drejtave që duhet të gëzojnë në kushte të barabarta me të tjerët. Në këtë kontekst vjen dhe ky raport, si një nevojë për monitorim, pas miratimit të një numri të lartë ligjesh e vendimesh që trajtojnë çështje të aksesueshmërisë dhe në veçanti VKM-së Numër nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” i cili rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë aksesueshmërinë.

Aksesueshmëria përbën parakusht për të realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, Shqipëria ende përballet me sfida të mëdha në eliminimin e pengesave.⁶

II. METODOLOGJIA

Me qëllim përmbushjen e objektivave të mësipërme dhe në mënyrë që gjetjet e këtij monitorimi të ishin sa më gjithëpërfshirëse, të dhënat u mbledhën duke përdoruar alternimin e të dhënave sekondare dhe atyre primare, të përfutuara nga disa burime.

a. Të dhënat sekondare

⁴ Manual për aksesueshmërinë dhe standardet, ribotim, 2014, ISO, IEC

[http://isotc.iso.org/livelink/livelink/fetch/2000/2122/4230450/8389141/ISO IEC Guide 71 2014%28E%29 Guide for addressing accessibility in standards.pdf?nodeid=8387461&vernum=-2](http://isotc.iso.org/livelink/livelink/fetch/2000/2122/4230450/8389141/ISO%20IEC%20Guide%2071%202014%28E%29%20Guide%20for%20addressing%20accessibility%20in%20standards.pdf?nodeid=8387461&vernum=-2)

⁵ Manual për adresimin e aksesueshmërisë përmes standardeve, edicion i robotuar, 2014, CEN-CENELEC

ftp://ftp.cencenelec.eu/EN/EuropeanStandardization/Guides/6_CENCLCGuide6.pdf

⁶ Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016-2020

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf

Të dhënat sekondare u mblodhën përmes rishikimit të literaturës ekzistuese, dokumentave ligjore dhe politike, kombëtare e ndërkombëtare në fushën aksesueshmërisë si dhe të dhënave ekzistuese të mundësuar nga raportet e identifikuar.

Rishikimi i literaturës pati për qëllim që të identifikojë kuadrin ligjor si dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare mbi bazën e të cilave aksesueshmëria duhet garantuar. Bazuar në sa më sipër, rishikimi i literaturës u fokusua në shqyrtimin e dokumenteve ndërkombëtare, në veçanti Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, kuadrin të brendshëm ligjor dhe politik mbi aksesueshmërinë, jurisprudencën e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Komentin e Përgjithshëm të këtij Komiteti mbi aksesueshmërinë.

Të dhënat sekondare të mbledhura gjatë fazës së parë të monitorimit shërbyen si udhërrëfyes për hartimin e instrumenteve të mbledhjes së të dhënave primare gjatë intervistimeve të kryera në fazën e dytë të monitorimit. U përgatitën disa pyetësorë për institucionet e përzgjedhura, të përshtatura sipas detyrimeve ligjore të çdo institucioni për të siguruar aksesueshmërinë.

Të dhënat primare u mblodhën përmes: (i) intervistave me personat kyç me përfaqësues të institucioneve kryesore të përzgjedhura, (ii) pyetësorëve të shpërndarë në institucione në rrugë zyrtare, (iii) fokus grupit me persona me aftësi të kufizuara⁷. Duke pasur parasysh fushënveprimin e VKM-së Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, objekt të këtij monitorimi, fillimisht u realizua identifikimi i disa prej institucioneve kyç në zbatimin e tij në rajonet e Tiranës, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.⁸ Në total gjatë zhvillimit të monitorimit u kontaktuan 74 institucione në katër rajonet, prej të cilave rreth 24% (n=18) nuk i janë përgjigjur pyetjeve të dërguara apo kërkesave për takime.

Intervistat me personat kyç: Gjatë monitorimit u zhvilluan 39 intervista me persona kyç në institucione e përzgjedhura, të cilat kishin për qëllim mbledhjen e informacionit mbi masat e marra nga ana e tyre për zbatimin e legjislacionit që rregullon aksesueshmërinë, nivelin e njohurive për zbatimin e VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, identifikimin e gjendjes aktuale, burimeve dhe problemeve për garantimin e aksesueshmërisë, si dhe njohurive të përgjithshme të tyre në lidhje me aksesueshmërinë.

⁷ Lista e plotë e institucioneve të kontaktuar gjendet në Aneksin 1.

⁸ Këto janë rajone ku realizohet projekti “Qeverisja e mirë në kontekstin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara: Rruga përpara” me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në kuadër të projektit “Drejtësi për të gjithë”. Institucionet u përzgjedhën duke mbajtur në vëmendje fushat të cilat janë përcaktuar si prioritare në VKM- në Nr. 1074.

Pyetësorët e dërguar pranë institucioneve: Gjatë monitorimit u plotësuan 17 (n= 17) pyetësorët e dërguar përmes postës dhe e-mailit, koordinatorëve të informimit të institucioneve të përzgjedhura.

Fokus grup me personat me aftësi të kufizuara: Në këtë pjesë të të dhënave primare u mbledhën të dhëna përmes realizimit të një fokus grupi me 10 persona me aftësi të kufizuara. Personat u përzgjedhën në mënyrë tillë që të përfaqësonin të gjitha grupimet dhe llojet e aftësisë së kufizuar. Të dhënat e përfutuara nga fokus grupi i realizuar synuan që të evidentonin nivelin e njohurive të personave me aftësi të kufizuar në lidhje me VKM Numër 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.⁹ Edhe pse VKM-ja parashikon detyra dhe përgjegjësi për institucionet shtetërore dhe ato private, personat me aftësi të kufizuara konsiderohen si aktorë kyç në zbatimin e saj dhe u përfshinë me qëllim realizimin e një monitorimi sa më gjithëpërfshirës, për të dhënë edhe perspektivën e tyre në lidhje me aksesueshmërinë e sidomos për të përforcuar rëndësinë themelore që ka vetë komuniteti në monitorimin e kuadrit ligjor që lidhet drejtëpërdrejtë me të.

Në zonat ku u zhvilluan intervista të thelluara, disa përfaqësues (n= 12) u kontaktuan në mënyrë elektronike dhe përmes telefonit për t’i kthyer përgjigje pyetjeve të përgatitura. Kjo ishte dhe hallka më e vështirë e monitorimit duke qenë se një numër personash nuk kthyen përgjigje brenda afatit të caktuar ose përgjigjet e dhëna ishin të pjesshme.

Mbledhja e të dhënave primare dhe sekondare për këtë vlerësim u krye gjatë periudhës Prill-Qeshor 2017.

Kufizime

Megjithëse monitorimi arriti të përmbushë objektivat e vendosura, ai pati edhe disa kufizime të pashmangshme. Kufizimet kanë të bëjnë me disa aspekte: (a) Së pari, për shkak të mungesës së përgjigjeve në disa raste, përgjigjeve të pjesshme apo të vonuara nga institucionet e përfshira në këtë monitorim, informacioni shpeshherë nuk është i plotë dhe gjithëpërfshirës në masën që synonte të ishte; (b) Mungesa e informacionit, mungesa e koordinimit brenda institucioneve, shpeshherë dëgjimi për herë të parë i termave të lidhura me aksesueshmërinë e bënte të vështirë zhvillimin e intervistave dhe pasqyrimin e përpiktë të informacionit apo opinioneve të dhëna nga përfaqësuesit e institucioneve të kontaktuara; (c) Nga ana tjetër, mungesa e mekanizmave të brendshme verifikuese të gjendjes të institucioneve rajonale apo në institucionet qendrore përsa i përket aksesueshmërisë, moszhvillimi i indikatorëve të posaçëm apo i planeve, mungesa e njohurive më të thelluara në

⁹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/243.pdf

lidhje me spektrin e gjerë të aksesueshmërisë patën ndikimin e tyre gjatë procesit të mbledhjes së informacioni të përfutur prej tyre. Megjithatë këto barierra dhe kufizime u adresuan nga grupi që kreu monitorimin përmes verifikimit të përgjigjeve nga disa burime brenda institucioneve dhe jashtë tyre, sqarimeve të detajuara të pyetjeve dhe termave apo ripërsëritjes së intervistave për aspekte të veçanta të instrumentave për të cilët përgjigjet ishin të paqarta.

III. KONSIDERATA TEORIKE MBI AKSESUESHMËRINË

Lëvizja e personave me aftësi të kufizuara në botë ka theksuar gjithmonë që asnjë nga të drejtat e këtij komuniteti nuk mund të realizohet pa garantuar një mjedis, transport apo komunikim të përshtatur për ta.¹⁰

Nuk është rastësi që aksesueshmëria përfshihet në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara, si një parim i kësaj konventë, por edhe si një e drejtë nga ana tjetër.

Aksesueshmëria shfaqet si parim në nenin 3, pika f, të KDPAK duke theksuar të gjitha aspektet e aksesueshmërisë siç janë, heqja e barierrave sociale apo qëndrimore ndaj aftësi të kufizuar që përfshin sjelljet negative dhe stigmën ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre, sigurimin e formateve të përshtatshme dhe formave të komunikimit për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me problem të komunikimit, sigurimin e formateve alternative të komunikimit, sigurimin e aksesit në institucione. Aksesueshmëria kërkon që politikat, legjislacioni dhe praktikat që ndiqen të mos përjashtojnë personat me aftësi të kufizuara. Kërkohej gjithashtu heqja e barierrave fizike dhe aksesit ekonomik, si një e drejtë me natyrë ekonomike dhe sociale e lidhur ngushtësisht me konceptin e përbalueshmërisë, sikurse përdoret në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore.¹¹ Në këto dokumenta sigurisht që aksesueshmëria nuk është trajtuar në dimensionin të cilin ka tashmë, por aty mund të gjejmë fillesat e trajtimit të kësaj të drejte, për të gjithë njerëzit dhe jo në veçanti për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Ndërkohë, si e drejtë për akses shfaqet në disa dokumenta të tjera ndërkombëtare, duke filluar nga Rregullat Standarde për Barazi Mundësish, të cilat konsiderohen edhe si paraprirëse të KDPAK, por të cilat duhet theksuar, janë një dokument politik pa fuqi ligjore.

¹⁰ Përfshirja: Drejt përfshirjes së aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit urban gjithëpërfshirës. Rekomandime për një agjendë urbane gjithëpërfshirëse; The Global Network on Disability Inclusive and Accessible Urban Development (DIAUD)

<http://www.disabilityinclusivedevelopment.org/system/files/the-inclusion-imperative-towards-disability-inclusive-and-accessible-urb.pdf>

¹¹ Manual për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Të kuptuarit e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, faqe 46, 47; Marianne Schulz, 2010.

http://www.hiproweb.org/uploads/tx_hidrtdocs/HICRPDManual2010.pdf

Rregullat standarde në rregullin numër pesë trajtojnë rëndësinë që duhet të ketë për shtetet sigurimi i aksesueshmërisë për arritjen barazisë së mundësive të personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmërinë, ky dokument e trajton duke përfshirë disa dimensione të saj, duke përfshirë kështu ambjentin fizik dhe aksesin në informacion dhe komunikim. Rregullat Standarde përfshijnë të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar. Nga ana tjetër rekomandohet që Shtetet duhet të inkurajojnë Mediat, e shkruara apo vizive që të jenë të aksesueshme. Përsa i përket sistemeve teknologjike, kërkohet që ato të jenë që në fazën e krijimit të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara ose, në rast të kundërt, të përshtaten në faza të mëvonshme me nevojat e tyre. Ata vendosin theksin te rëndësia kyçe e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në gjitha fazat e dizenjimit apo hartimit të programeve, ligjeve dhe politikave.¹²

Për t'iu rikthyer fillesave të së drejtës së aksesit në dokumenta të tjera ndërkombëtare, gjurmët e para i gjejmë në dy konventa, përveç rregullave të sipërpërmendura. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, përmend të drejtëne personit për të lëvizur lirisht Brenda dhe jashtë shtetit si dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij, të drejtën për akses në jetën publike duke respektuar parimin e barazisë.¹³ Ndërsa, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit, e cilat në kuadër të detyrimeve që vendos për shtetet, për parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit racial, përmend edhe të drejtën e hyrjes (aksesit) në të gjitha lokalet dhe shërbimet që janë në shfrytëzim të publikut, si mjetet e transportit, hotelet, restorantet, kafenetë, sallat e shfaqjeve dhe parqet.¹⁴

Sikurse u përmend edhe më lart, këto dy konventa nuk e trajtojnë të drejtën për të patur akses në mënyrë specifike për personat me aftësi të kufizuara. Këto dy konventa të drejtën e aksesit e trajtojnë në mënyrë të përgjithshme dhe për të gjithë njerëzit, duke përfshirë këtu patjetër edhe përmes parimit të mosdiskriminimi personat me aftësi të kufizuara por gjithsesi jo në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Aksesueshmëria nuk ka një përkufizim në KDPAK por qartazi, si parim, aksesueshmëria është e vetmja mënyrë praktike për zbatimin e të drejtave si punësimi, arsimit, jetesa e pavarur, pjesëmarrja në jetën politike apo publike e të tjera. Ndërkohë një koncept shumë i rëndësishëm që shfaqet edhe në konventë është ai i projektimit universal.

Sipas KDPAK, "Projektim universal" do të thotë projektim i mallrave, mjedisit, programeve dhe shërbimeve për t'i bërë të përdorshme për të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë.

¹² Rezoluta mbi Rregullat Standarde për Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara A/RES/48/96 miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, 4 March 1994
<http://www.un.org/disabilities/documents/gadocs/standardrules.pdf>

¹³ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25, pika c; 23 mars 1976
<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>

¹⁴ Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, neni 5, pika f, 4 Janar 1969
<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CERD.aspx>

Por duhet mbajtur në vëmendje, që projektimi universal nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmëse për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme.

Projektimi universal është një filozofi e projektimit me shpejtësi që ka rrënjët e saj në historinë e projektimit pa pengesa që në vitet 1980 dhe 1990.

Ndërsa fokusi i projektimit pa pengesa kishte të bënte vetëm me sigurimin e lehtësirave të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, projektimi universal ka një qasje shumë më të gjerë bazuar në marrjen parasysh të karakteristikave të larmishme të popullatës në tërësi.¹⁵

IV. VLERËSIM I KUADRIT LIGJOR DHE POLITIK MBI AKSESUESHMËRINË

Në këtë kapitull trajtohet gjendja aktuale e aksesueshmërisë në Shqipëri duke iu referuar dy raporteve kryesore: Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Raportit Kombëtar të dorëzuar nga Qeveria Shqiptare pranë OKB-së.

Në vijim është kryer një analizë ligjore e dokumentave kryesore ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar që rregullon çështjen e aksesueshmërisë.

Dhe në fund të tij, analizohet në mënyrë të veçantë VKM- ja Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

IV 1. Gjendja e aksesueshmërisë në Shqipëri në këndvështrimin e raporteve

Duke iu referuar dy dokumentave kryesore, Planit të Veprimit të Personave me Aftësi të Kufizuara 2016-2020¹⁶ miratuar me VKM nr. 483, datë 29.6.2016 dhe Raportit fillestar të Shtetit Shqiptar për KDPAK, bazuar në nenin 35 të KDPAK në Maj 2015¹⁷ gjendja e aksesueshmërisë ka njohur progres por ai ka qënë i pamjaftueshëm. Ndërkohë që raporti fillestar i shtetit rezulton më optimist në paraqitjen e situatës në krahasim me planin kombëtar të veprimit, të dy dokumentat dokumentojnë sfidat e mëdha që ka shteti Shqiptar për zbatimin e legjislacionit të miratuar.

Kështu, sipas këtyre dokumentave, Shqipëria ka bërë progres në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Dokumentat i referohen

¹⁵ Indikatorët kryesore për aksesueshmërinë, KDPAK, The Global Alliance on Accessible Technologies and Environments (GAATES), Maj 2015.

http://gaates.org/wp-content/uploads/2014/07/FINAL-Toolkit_-UN-CRPD-KEY-INDICATORS-OF-ACCESSIBILITY-2015-06-29.pdf

¹⁶ Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf

¹⁷Raporti fillestar i Shtetit Shqiptar bazuar mbi nenin 35 të KDPAK, Maj 2015

http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fALB%2f1&Lang=en

në mënyrë të veçantë legjislacionit të miratuar për garantimin e aksesueshmërisë, në disa fusha, si në fushën e ndërtimit, transportit, strehimit etj.

Ndërkohë që në këto dokumenta pasqyrohen disa projekte si arritje në fushën e aksesueshmërisë, si realizimi i disa broshurave për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, shërbimet e ofruara në qendrat shtetërore rezidenciale, që orientojnë personat me aftësi të kufizuara përmes udhëzimeve të thjeshtuara se si të lëvizin në mënyrë të pavarur, ngritjen e një grupi ndërministror për evidentimin e institucioneve shtetërore të papërshtatura, ndër të cilat u inspektuan 70 dhe marrjen e masave, projektin e bashkisë së Tiranës „Një qytet pa barierra“, në bazë të të cilit u vendosën 390 rampa dhe u krijuan 35 vende parkimi për personat me aftësi të kufizuara, njihjen zyrtare të gjuhës së shenjave e disa të tjera.

Megjithatë pranohet që *“Shqipëria ende përballlet me sfida të mëdha në eliminimin e pengesave. Shumë ndërtesa publike dhe hapësira publike të jashtme dhe faqe interneti qeveritare nuk janë të aksesueshme. Personat me probleme në dëgjim pothuajse nuk kanë fare akses në shërbimet private ose publike duke përdorur gjuhën e shenjave.”*Ndërkohë që nuk ka asnjë progres në lidhje me shënjat e vendosura në mjedise publike për këtë komunitet.

Më tej plani vijon me gjetjet në lidhje me lëvizshmërinë personale, *“Lëvizja e pavarur në rrugë dhe në trotuare është pothuajse e pamundur për personat në karrige me rrota apo që përdorin shkop. Shumë pak trotuare janë përshtatur , ata mund të jenë të ngushtë dhe shpesh sipërfaqja e tyre nuk është e njëtrajtshme. Transporti publik mbetet i paaksesueshëm. Edhe pse qeveria ka miratuar standardet përkatëse, ata nuk zbatohen në praktikë.*

Në kryqëzimet e rrugëve apo në transportim publik nuk ekzistojnë sinjalizimet zanore dhe stacionet e autobusit janë të pashënuar, duke e bërë orientimin të vështirë. Shumë pak rrugë dhe ndërtesa publike përfshijnë shenja të ngritura ose të përshtatura për të verbërit si dhe mungojnë mjetet ndihmëse si shkopinj të bardhë , qentë orientues dhe qentë ndihmës.

Në fushën e arsimit në plan konstatohet që *“Gjatë dhjetë viteve të fundit, objektivat e përcaktuara në Planin e mëparshëm të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara (për numrin e shkollave të aksesueshme, ambienteve parashkollore dhe qendrave të AFP-së¹⁸) nuk u arritën.”*

Më tej në plan paraqitet edhe situata e përdorimit të formateve audio apo teksteve në Braille: *“... shkollare të shkollave të përgjithshme nuk ekzistojnë në alfabetin Braille apo në formate audio. Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë nuk mund të plotësojë kërkesat për tekste shkollare në alfabetin Braille për shkak të fondeve të kufizuara dhe kapacitetit teknik të kufizuar.”*

Plani më tej vijon me konstatimin që *“disa ndërtesa qeveritare janë të aksesueshme. Shumë të tjera po rikonstruktohen me qëllim që të garantojnë aksesueshmëri të plotë për PAK. Janë të pakët personat me aftësi të kufizuar të punësuar në institucione qendrore dhe vendore.”*

Në lidhje me legjislacionin ekzistues që prej vitit 2008, Këshilli i Ministrave miratoi një vendim *“Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, i cili parashikon standardet e aksesueshmërisë dhe normat që duhet të zbatohen në industrinë e ndërtimit (veçanërisht në lidhje me aksesin nëpër ndërtesa, rrugë dhe*

¹⁸ Në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2005-2015, qeveria u angazhua të bëjë të aksesueshme 100 shkolla, 90 kopshte dhe tetë qendra AFP (Aktiviteti 1.4).

mjedise të tjera të brendshme dhe të jashtme) plani shprehet që “këto standarde nuk mbikqyren në mënyrë sistematike dhe zbatimi i tyre nuk monitorohet.”

Përsa i përket sektorit privat, plani konstaton që “standartet e aksesueshmërisë zbatohen shumë rrallë. Shumica e objekteve turistike private nuk janë të aksesueshme dhe ky aspekt nuk trajtohet nga inspektimet për turizmin. Rrjedhimisht, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përballen me pengesa për të marrë pjesë në veprimtari argëtuese dhe në turizëm. Gjithashtu, kjo nënkupton se personat me aftësi të kufizuara shpesh nuk mund të punësohen në industrinë e turizmit, e cila zë një përqindje të konsiderueshme të ekonomisë në Shqipëri.”

Ndërsa në lidhje me transportin, plani shprehet që “në praktikë, pothuaj asnjë mjet transporti publik nuk është i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara. Monitorimi nuk është efikas dhe nuk është vendosur asnjë penaltitet për moszbatimin e tyre. “

Përsa i përket fushës së teknologjisë së informimit dhe Media-ve, plani konstaton që “faqet qeveritare të internetit dhe portalet nuk janë të aksesueshme për programet e leximit dhe për personat që kanë nevojë për shkrim të madh apo kontrast.

Programet televizive në gjuhën e shenjave ishin të kufizuara vetëm në televizionin kombëtar (TVSH) që transmeton një program informativ prej 10 minutash në ditë, i cili nuk transmetohet më.”

IV 2. Përmbledhje e kuadrit ligjor ndërkombëtar mbi aksesueshmërinë

Me ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012 me Ligjin 108/2012 më datë 15.12.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” (KDKPAK). Aksesueshmëria sipas KDKPAK është përkthyer si heqje barierrash¹⁹ dhe është një nga shtatë parimet kryesore të KDKPAK. Aksesueshmëria (heqja e barierrave) është një nga parimet themelore të KDKPAK, duke qënë se përmes saj personat me aftësi të kufizuara arrijnë të gëzojnë dhe të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera në KDKPAK si dhe mundësohet mbi të gjitha jetesa e pavarur e tyre.

KDKPAK përmes nenit 9 vendos mbi shtetet palë detyrimin për të eliminuar barierrat në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë e sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Shtetet duhet të marrin masa përmes identifikimit të barierrave dhe eliminimit të tyre në ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës, informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës.

KDKPAK përveç se kërkon zbatimin e aksesueshmërisë në të gjitha fushat, për të drejtat civile dhe politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, nuk bën dallim mes sektorit publik dhe privat, por vendos mbi të gjithë detyrimin, kërkon vendosjen e standardeve minimale dhe hartimin e

¹⁹ Ka pasur disa diskutime mbi përkthimin e termit “Accessibility”. Në konventë rezulton të jetë “heqje barierrash” kurse ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë ka përdorur termin “Aksesueshmëri

udhëzuesve për eliminimin e barierrave në të gjitha fushat e sipërpërmendura, si dhe trajnimin e stafit.

KDPAK liston disa forma dhe formate të cilat mund të konsiderohen si disa nga mënyrat për të siguruar aksesueshmërinë. Këto janë:

- *ndërtesat dhe mjete të tjera të hapura për publikun;*
- *shenja në Braille dhe në një formë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;*
- *forma asistence të drejtpërdrejta dhe të ndërmjetme, përfshirë udhëzues, lexues dhe përkthyes profesionalë të gjuhës së shenjave, për të lehtësuar hyrjen në ndërtesa dhe mjete të tjera të hapura për publikun;*
- *forma të tjera të përshtatshme asistence dhe mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar që atyre t'u mundësohet informacioni;*
- *mundësimin e informacionit të ri dhe sistemet e teknologjitë e reja të komunikimit për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe internetin.*

Më 22 Maj 2014 u botua **Komenti i Përgjithshëm²⁰ i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**. Komiteti e ka trajtuar aksesueshmërinë si një faktor themelor në zbatimin e konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Nisur nga kjo, Komiteti ka hartuar komentin e përgjithshëm, i cili sqaron në mënyrë më të detajuar se çfarë përfshin aksesueshmëria dhe si duhet konsideruar ajo në fusha të ndryshme.

Komiteti thekson që aksesueshmëria mund të garantohet vetëm përmes zbatimit të standardeve strikte. Komiteti përfshin në koment edhe konceptin e projektimit universal i përkufizuar si *projektim i mallrave, mjedisit, programeve dhe shërbimeve për t'i bërë të përdorshme për të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë. Projektimi universal nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmese për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme.*

Komenti më tej sikurse edhe vetë KDPAK sqaron se nuk mjafton aplikimi i projektimit universal si masë vetme pasi nuk siguron në të gjitha rastet aksesueshmërinë. Janë thelbësore edhe ndërhyrjet e posaçme për personat me aftësi të kufizuara, pajisjet e caktuara si karriget me rrota, patericat, mjetet dëgjimore, formate të tjera të posaçme për lloje të caktuara aftësisht të kufizuara. Por në të gjitha rastet është thelbësore që shërbimet apo produktet të dizajnohen duke u bazuar mbi këtë koncept. Kjo eliminon nevojat e mëvonshme që lindin për t'i përshtatur ato për personat me aftësi të kufizuara, të cilat janë më të kushtueshme. Pra, projektimi universal për garantimin e aksesueshmërisë ka edhe faktorin ekonomik si avantazh, pasi është më pak i kushtueshëm dhe përfiton një grup të madh 'klientësh', të cilët nuk janë vetëm personat me aftësi të kufizuara, pra, i vlejné të gjithë

²⁰ Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 22 Maj 2014

http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/2&Lang=en

komunitetit. Komiteti riliston fushat në të cilat zbatohet dhe garantohet aksesueshmëria dhe gjithashtu ripërcakton të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar në raport me të cilat duhet të sigurohet aksesueshmëria. Duke qenë se aksesueshmëria përbën parakusht që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në shoqëri, mohimi i aksesit në mjedis, transport, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, në shërbimet e hapura për publikun duhet të shihet gjithmonë si diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, sipas këtij komenti. Duhet bërë një dallim i qartë midis detyrimit për të siguruar që të gjitha objektet, infrastruktura, mallrat, produktet dhe shërbimet e projektuara, ndërtuara ose prodhuara rishtazi të jenë të aksesueshme dhe detyrimit për të hequr barrierat në ato ekzistuese dhe për të siguruar një mjedis, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun e gjerë. Ky dallim theksohet në koment, pikërisht duke pasur parasysh faktin që ndërkohë që projektimi universal, pra garantimi i aksesueshmërisë në produktet e shërbimet e reja do të realizohet në mënyrë graduale, shtetet që ratifikojnë konventën duhet të marrin masa për heqjen e pengesave ekzistues, duke vendosur afate kohore dhe duke përcaktuar buxhetet e nevojshme.

IV. 3 Kuadri ligjor kombëtar

Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara Nr. 93/2014²¹.

Diskutimi mbi nevojën për të pasur një ligj kuadër për personat me aftësi të kufizuara kishte kohë që zhvillohej në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, me argumentimin që mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komunitetit nga legjislativi i përgjithshëm nuk ishte i mjaftueshëm apo efektiv. Pas ratifikimit të KDPAK nga shteti Shqiptar, u arrit në përfundimin që një ligj i tillë nuk do të kishte efektet e pritura, pasi tashmë KDPAK e ratifikuar ishte pjesë e sistemit të brendshëm ligjor. Një ligj kuadër do të ishte thjesht një replikim i KDPAK e nuk do të luante ndonjë rol të veçantë për të drejtat e komunitetit. Duke qenë se projekti për ligjin e ri kishte kaluar në disa faza të hartimit dhe konsultimit, u mendua gjatë tyre që ky ligj të shërbente për adresimin e disa çështjeve shqetësuese për komunitetin por edhe për institucionet shtetërore. Në këtë frymë, ligji arriti të grupojë disa nga çështjet, që duheshin adresuar tashmë në Shqipëri, dhe të cilat ndihmojnë në kuptimin dhe zbatimin më të mirë të KDPAK. Të tilla çështje janë: komisionimi ose vlerësimi i personave me aftësi të kufizuara, monitorimi i zbatimit të KDPAK në nivel të brendshëm, sqarime në lidhje me koncepte të cilat përbëjnë risi sikurse janë vendimarrja e mbështetur, barazia para ligjit, shërbime të jetesës së pavarur, përkufizimi, administrimi i mjeteve ndihmëse, ngritja e pikave fokale dhe çështje të kujdestarisë ose ndihmësve personalë. Të gjitha këto çështje të marra sëbashku janë të ndërvarura nga njëra tjetra ose janë rrjedhoja ligjore të njëra tjetrës. Kështu çështja e vlerësimit lidhet me caktimin e ndihmësive personal apo me shërbimet e jetesës së

²¹ Ligji është miratuar më datë 24.07.2014 dhe i botuar ne Fletoren Zyrtare numër 135, më datë 28 Gusht 2014

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf

pavapur dhe nga ana tjetër vendimarrja e mbështetur merr një rol thelbësor në këtë ligj, duke i dhënë vetë personit mundësinë për të zgjedhur personat që do të ofrojnë mbështetjen, duke ndikuar në rritjen e pavarësisë së personit. Tashmë me këtë ligj rregullohen disa fusha thelbësore për jetesën e pavarur dhe plotësohen disa boshllëqe ekzsituose legjislativë. Në një mënyrë, mund të thuhet, që ky ligj tenton të kodifikojë “aftësinë e kufizuar” nën një ombrellë. Ndërkohë që në Shqipëri legjislacioni vazhdon të mbetet i fragmentizuar, KDPAK nuk bën dallime mes llojeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar por përdor termin ‘aftësi e kufizuar’ duke mos e përkufizuar atë qëllimisht, por duke e lënë të hapur pasi konsiderohet një term që evolon me kohën dhe si i tillë nuk mund të përkufizohet. Ekzistenca e shumë ligjeve të cilat mbrojnë më shumë disa ‘aftësi të kufizuara’ në krahasim me disa të tjera, ka shkaktuar një situatë diskriminuose mes komuniteteve të aftësisë së kufizuar. Ky ligj synon qartazi që përmes vlerësimit të përshtatshëm të caktojë llojin dhe masën e aftësisë së kufizuara në të gjitha dimensionet e saj, duke vlerësuar nevojat që vijnë si pasojë e aftësisë së kufizuar, duke hequr dorë nga vlerësimi vetëm bazuar në përkatësinë në statuse ligjore të caktuara, të bazuar mbi modelin e vjetruar mjekësor.

Përveç trajtimit të përgjithshëm të mësipërm në lidhje me Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë, i rikthehem aksesueshmërisë. Qëllimi kryesor i ligjit, sikurse shprehet dhe neni 1 i tij është të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe nga ana tjetër ***të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara.*** Duke u nisur edhe nga vetë emërtimi i ligjit, aksesueshmëria luan një rol qendror në këtë ligj për përfshirjen dhe garantimin e të drejtave, sikurse rezulton edhe në qëllimin e ligjit: “...në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara...”

Ligji është përpjekur në mënyrë maksimale, për aq sa është e mundur të përkufizojë termin ‘aksesueshmëri’, një term të cilin KDPAK vetë nuk e ka përkufizuar për arsye të kompleksitetit dhe dinamikës gjithmonë në zhvillim që ai paraqet.

“Aksesueshmëri” sipas ligjit është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.

“Pengesat” nënkuptojnë:

- a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;
- b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;
- c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;
- ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Ky ligj, i miratuar në frymën e KDPAK duket të ketë përparësi mbi legjislacionin ekzistues, duke qënë se edhe vetë përcakton, që ***“do të udhëheqë ndryshimet graduale në legjislacion”***

në drejtim të përmirësimit në frymën e KDPAK, si në aspektin terminologjik por edhe në qasje e drejtime.

Duke qënë se ky mbetet një ligj i përgjithshëm, ai delegon në aktet nënligjore çështje shumë të rëndësishme. Në lidhje me aksesueshmërinë, përveç detyrimeve dhe përgjegjësi që kanë të gjitha institucionet për sigurimin e saj në mënyrë progresive, ligji në nenin 11 parashikon në pikën 3, që masat për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

IV 4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

Në zbatim të Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.²²

Qëllimi i vendimit është që të detajojë përkufizimet apo parimet e vendosura nga Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Vendimi përveçse përcakton masat për zbatimin në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara shërben edhe për unifikimin e rregullave ekzistuese me ato të reja. Sqarimi dhe detyrimi për masat që duhet të ndërmarrin të gjitha institucionet buron direkt nga ligji, por nga ana tjetër ky vendim, sikurse vetë ligji merr në konsideratë bazën ligjore ekzistuese (ligje dhe vendime) të cilat tashmë rregullojnë disa aspekte të aksesueshmërisë. Kështu, ndër disa copëza legjislacioni²³ mund të veçojmë disa më kryesoret:

Ligjin për Transportin Rrugor i cili parashikon detyrimin që të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta. Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa,

²² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/243.pdf

²³ Aspekte të veçanta në mënyrë të pjesshme të aksesueshmërisë rregullohene dhe në legjislacionin për transportet, Mediat Audiovizive, Për administrimin e bashkpronësisë në ndërtesat e banimit, “Për statusin e të verbërit, “Statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik, arsimin parauniversitar etj.

kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave²⁴;

Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”. Rregullorja ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike dhe **Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”** sanksionon konceptin “Hapësirë e përshtatur” si “hapësira që ofron përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuar ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta”. Duhet theksuar që këto dy instrumenta ligjore shumë të rëndësishme për aksesueshmërinë e trajtojnë në mënyra dhe dimensione të kufizuara atë dhe nuk i përmbahen kuptimit gjithëpërfshirës që ky term ka sipas KDPAK dhe Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Ato rregullojnë aspektet fizike të ambienteve publike dhe private, duke u përqëndruar kryesisht në personat me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore apo ndijore por vetëm në barierrat arkitektonike. Pra, ato nuk përfshijnë të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar. Në to përdoren terma si mundësi hyrjeje, mundësi shfrytëzimi apo përshtatshmëri²⁵, të cilat mbulojnë në mënyrë të pjesshme disa aspekte të aksesueshmërisë, ndërkohë që aksesueshmëria kërkon eliminimin e të gjitha llojeve të pengesave për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara sipas KDPAK dhe Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë.

Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” parashikon në Kreun II, pika 1 dhe 2, që niveli i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara të garantohet në përputhje me kërkesat teknike, në çdo rast. Përsa i përket kërkesave teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve në veçanti, vendimi parashikon që do të zbatohen sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Pra, ky vendim siguron që aksesueshmëria merr kuptimin më të fundit të dhënë nga vetë KDPAK dhe zhvillimet e fundit por njëkohësisht përforcon në kontekstin e zbatimit kuadron ligjor ekzistues dhe sigurohet që të ketë karakter gjithëpërfshirës dhe plotësues duke iu referuar drejtpërdrejtë VKM-së “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”përsa i përket aspekteve teknike të sigurimit të përshtatshmërisë.

Ky vendim, i cili është edhe objekti kryesor i monitorimit, është ndër vendimet që përpiqet në mënyrë të plotë t’i japë zgjidhje problemeve ekzistuese në lidhje me zbatimin e

²⁴ <http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2015/07/LIGJI-PER-TRANSPORTET-RRUGORE-I-perditesuar.pdf>

²⁵ Mundësia e hyrjes shpreh nivelin më të lartë të shfrytëzimit total të hapësirave në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Mundësia e shfrytëzimit përfaqëson një nivel të mundësisë së kufizuar, të një hyrjeje, të ndërtesës ose të njësie të patundshme, por që lejon mundësinë e krijimit të marrëdhënieve të domosdoshme edhe për personat me aftësi të kufizuara motorike ose ndijuese. Përshtatshmëria është një mundësi hyrjeje e diferencuar që përfaqëson një nivel bazë, me mundësi për t’u përmirësuar.

aksesueshmërisë në Shqipëri. E themi këtë duke pasur në vëmendje faktin, që kuadri ligjor ekzistues ka pasur një nivel shumë të ulët zbatimi, sidomos sepse nuk ka pasur ose nuk janë ushtruar mekanizmat kontrollues të parashikuara në to dhe njëkohësisht nuk janë aplikuar sanksione ndaj subjekteve. Shpeshherë mungojnë sanksionet, pamundësohet aplikimi i tyre sidomos në fushën ndërtimore ose dispozitat janë të paqarta. Të gjitha këto problematika janë adresuar në VKM-në Nr. 1074. Vendimi është përpjekur që të përkufizojë pengesat e t'i vendosë këto pengesa në raport më të gjitha llojet e aftësive të kufizuara, duke përcaktuar në mënyrë të qartë institucionet përgjegjëse dhe hapat që duhen të ndiqen nga ana e tyre për zbatimin e aksesueshmërisë ose eliminimin e pengesave, me plane dhe afate kohore. Vendimi ka përcaktuar gjithashtu edhe institucionet përgjegjëse për monitorimin e tyre duke u përpjekur që të bëjë edhe një ndërlidhje të monitorimit me institucioneve në nivel qendror (MMSR), qendror dhe rajonal (ISHPSHSH)²⁶ dhe KKAK, dhe gjithashtu përcakton një procedurë ankimi.

Vendimi jep për aq sa është e mundur një përkufizim të pengesave ose i ndan ato në disa kategori kryesore. Sipas tij pengesat janë:

Janë pengesa në komunikim: a) vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim e dëgjim; b) vështirësitë në komunikim që kanë personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar. 3. Janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

Fusha e veprimit të këtij vendimi është shumë e gjerë. Vendimi përcakton një listë të gjatë të institucioneve shtetërore dhe private në të cilat shtrin efektet ky vendim dhe i ka grupuar ato katër grupime kryesore. Ato janë:

a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara;

b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët;

c) mjetet e transportit publik;

²⁶ Vendimi parashikon si institucion monitorues Inspektoratin Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili në rajone mund të operojë përmes degëve rajonale të tij.

ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

Në vijim, vendimi përcakton hapat kryesorë që çdo subjekt shtetëror apo privat duhet të ndjekë për të realizuar përshtatshmëri. Duke qënë të ndërgjegjshëm që zbatimi i këtij vendimi do t'i nënshtrohet parimit të realizimit progresiv për arsye të shpenzimeve financiare që kërkon fillimisht, janë përcaktuar edhe hapat duke respektuar këtë parim. Ky parim qartazi shprehet në pikën 12 të Kreut I: *“Subjektet planifikojnë në mënyrë progresive procesin e përshtatjes në përputhje me dispozitat e këtij vendimi”*. Çdo subjekt, ka detyrimin që, brenda 12 muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.

Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. Kujtojmë që vendimin është miratuar 23.12.2015 dhe ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, botim i cili ka ndodhur me 11 Janar 2016. Nga vendimi nuk rezulton që ka një format të miratur të këtij plani, pra që këto institucione të ndjekin një format të caktuar të detyrueshëm por vendos disa piketa kryesore të cilat plani duhet të përmbajë. Ato kanë të bëjnë me evidentimin e (1) objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, (2) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe (3) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. Në mënyrë shumë të kujdesshme vendimi është siguruar që të përfshijë aspektet kryesore në plan, të cilat sigurojnë maksimalisht zbatimin e këtij vendimi dhe të respektojë kërkesat e vendosura në Komentin e Përgjithshëm Nr. 2 (2014) të Komitetit për të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara mbi nenin 9 të KDPAK, Aksesueshmëria, sipas të cilave masat duhet të merren brenda një afati të caktuar kohor.

Plani i masave, një kopje e të cilit, sipas VKM-së, i dërgohet KKAK, miratohet me urdhër të titullarit ose drejtuesit të subjektit dhe bëhet publik në faqen e internetit e njëkohësisht i dërgohet edhe MMSR. Institucionet kanë edhe detyrimin për të hartuar një raport vjetor në lidhje me realizimin e planit të masave për sigurimin e aksesueshmërisë.

Në mënyrë graduale, pasi vendimi në pjesën e tij të parë të ‘Rregullimeve të përgjithshme’ përcakton qëllimin, fushën e veprimit të tij dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij, vijon me rregullimet e posaçme, duke përcaktuar detyrime specifike për institucionet kryesore.

Subjektet që ofrojnë shërbime publike, të cilat pothuajse mbulojnë të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e rregullave në këtë vendim, duhet të planifikojnë buxhetet e tyre në mënyrë progresive për të realizuar përshtatshmërinë në të gjithë dimensionin e saj. Në mënyrë specifike përmenden këto elemente: (i) proces komunikimi dhe informimi për individët me vështirësi shikimi ose plotësisht të verbër, (ii) duke botuar në gjuhën braille dhe/ose me shkrim të zmadhuar dhe/ose në formatin audio materiale të lidhura drejtpërdrejtë me interesat parësorë të këtij grupi njerëzish. Në fakt, ky detyrim është i ngjashëm dhe buron nga detyrimi që është përcaktuar për herë të parë në Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë sipas të cilit *“...ligji, ligje të tjera dhe aktet nënligjore përkatëse, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njëriut dhe veçanërisht me të drejtat dhe përfitimet e posaçme të*

personave me aftësi të kufizuar është i disponueshëm në format të aksesueshëm...”, i cili është printimi dhe botimi i teksteve në Braille, printim me shkronjë të madhe, në gjuhë të thjeshtuar, të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

Në këtë vendim të posaçëm për aksesueshmërinë formatet e përshtatura dhe të aksesueshme janë renditur në mënyrë më të zgjeruar dhe janë shtritur për të gjitha llojet e informacioni të prodhuar për të gjithë marrësit e tij.

Është me interes që vendimi ka përcaktuar disa institucione (fusha) të cilat duhet të kenë përparësi në aplikimin e parashikimeve të aksesueshmërisë, edhe pse ato janë të detyrueshme për të gjitha institucionet. Këto janë: institucionet e ligjit dhe tatim-taksave, institucionet e arsimit dhe botimit, të shëndetësisë, të punësimit e të transportit.

Ndër institucionet në nivel qendror, vendimi ka vendosur detyrime specifike për dy ministri kryesore: MAS dhe MMSR. Mund të supozojmë që vendimi është përpjekur që të adresojë fushat më problematike në realitetin shqiptar, pra aty ku hasen më shpesh pengesat për personat me aftësi të kufizuara dhe këtë e ka realizuar duke vendosur përparësi për disa fusha. Nga ana tjetër, duke qënë të ndërgjegjshëm për rolet udhëheqëse në fushën e aftësisë së kufizuar që kanë pasur MAS dhe MMSR i ka përzgjedhur ato duke i vendosur disa detyrime kryesore. Detyrimet kryesore të vendosura duken të mirëstudiuara pasi lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me disa shqetësime serioze dhe adresojnë mungesa të komuniteteve të personave me aftësi të kufizuara. MAS i janë ngarkuar disa detyrime që adreson kryesisht dy mungesa të mëdha në sistemin arsimor shqiptar në lidhje me personat me aftësi të kufizuar në shikim, në dëgjim dhe në të folur. Konkretisht për MAS vendimi parashikon këto detyrime:

MAS bën të detyrueshëm (pjesë të kurrikulës arsimore) mësimin e gjuhës Braille, krahas mësimin të gjuhës së shkruar dhe/ose të folur shqipe në shkollën speciale për personat që nuk shikojnë, e cila është pjesë e sistemit të arsimit të detyrueshëm.

- MAS siguron që 60% e stafit pedagogjik, përfshi organet drejtuese, të shkollës speciale për personat që nuk shikojnë janë persona që nuk shikojnë dhe që zotërojnë gjuhën braille.
- MAS përfshin në kurrikulat e arsimit të detyrueshëm për shkollën speciale për personat që nuk dëgjojnë mësimin e gjuhës së shenjave shqipe, krahas mësimin të gjuhës shqipe, të shkruar dhe/ose të folur.
- MAS merr masa që të paktën 10% e personelit pedagogjik të shkollës speciale për personat që nuk dëgjojnë janë persona që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin dhe që zotërojnë gjuhën e shkruar dhe gjuhën e shenjave shqipe.
- MAS ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë.

Ndërsa për MMSR detyrimet kanë të bëjnë me:

- MMSR zyrtarizon dhe publikon, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, kodin e gjuhës braille.

- MMSR në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimi të gjuhës së shenjave shqipe
- MMSR zyrtarizon dhe publikon, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Fjalorin e Gjuhës së Shenjave Shqipe.
- MMSR në bashkëpunim me akademikë dhe ekspertizën e OJF-ve, përgatit, boton dhe shpërndan një udhëzues/manual për punonjësit e institucioneve të shërbimeve publike për mënyrat e komunikimit e të informimit të personave me aftësi të kufizuara mendore, si dhe për mënyrën e përpilimit të materialeve të shkruara për këta persona.
- Ndërkohë, detyrime të veçanta ka edhe për disa institucione të tjera qendrore ose të pavarura siç janë: KQZ, Ministria e Punëve të Brendshme, Media.
- KQZ:
- Në bashkëpunim me bashkitë, realizojnë në raste të caktuara, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, procese komunikimi konsultimi dhe këshillimi në distancë, me ndihmën e teknologjisë (telefon /televizion/internet) si dhe nëpërmjet videokonferencave.

MB:

- Pajis forcat e rendit me njohuri bazë për sinjalistikën me audio dhe forma të tjera të përshtatura për lëvizshmërinë e pavarur të njerëzve të verbër, njohjen e shkopit të bardhë, gjuhës braille dhe shenjave të tjera dalluese, si mjete identifikuese të individëve të verbër.

Televizionet kombëtare dhe Media-t në përgjithësi:

- Televizionet kombëtare transmetojnë rregullisht emisionin kryesor të lajmeve në opSIONIN e transmetimit të shoqëruar me titra dhe me gjuhën e shenjave.
- Aplikojnë rregullat për aksesueshmëri nëpërmjet teknologjive të posaçme dhe ofrojnë për personat e verbër shpjegim në format audio të materialeve të transmetuara kryesisht me natyrë informuese, duke parashikuar në mënyrë progresive buxhetin përkatës për aplikim të përshtatshmërisë.

Ekzistojnë disa parashikime për institucionet që ofrojnë shërbimin e transportit. Përveç detyrimit për të siguruar aksesueshmëri, sipas rregullave ekzistuese tashmë në VKM Nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, vendimi shton edhe detyrimin për të garantuar sistem transporti për individët e verbër ose me dëmtim të shikimit, duke përfshirë sistem të shpjegimit me audio për orientim në linjat e transportit.

Përveç detyrimi për ta bërë transportin e aksesueshëm për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar, vendimi shkon edhe më tej duke ndërhyrë edhe në oraret e ofrimit të këtyre shërbimeve. Për transportin publik ofrojnë transport qytetas me mjete tërësisht të përshtatura minimumi çdo 1 (një) orë në çdo vendqëndrim dhe shërbim transporti ndërqytetas me mjete të përshtatura për personat me vështirësi në lëvizje, minimumi një herë në ditë.

Sikurse u përmend edhe më lart, aksesueshmëria para Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë dhe këtij vendimi, trajtohej vetëm në kuptimin arkitektonik, pra vetëm për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe deri diku për personat me aftësi të kufizuara shqisore. Tashmë ky vendim, sikurse Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë jep kuptimin e plotë të aksesueshmërisë. Në këtë kontekst, sikurse rezulton edhe nga detyrimet, ato i drejtohen në mënyrë të veçantë komunitetit të personave që nuk shikojnë, që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë dhe personave me aftësi të kufizuara mendore, duke plotësuar pjesën tashmë të rregulluar të aksesueshmërisë fizike. Në pjesën e Rregullave të Posaçme jepet përcaktimi për personat me aftësi të kufizuara të intelektit, i cili nuk është një përkufizim i mirëfilltë ezaures por kujdeset të përdorë termin ‘përfshin’ por listohen gjithashtu edhe disa teknika kryesore për të garantuara aksesueshmërinë në raport me ta. Kështu, në personat me aftësi të kufizuara të intelektit përfshihen:

- a) personat që kanë vështirësi në të lexuar dhe në të nxënë nëpërmjet gjuhës (disleksi), në të shkruar (disgrafi);
- b) personat me aftësi të kufizuara intelektuale /zhvillimi;
- c) personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor;
- ç) personat me aftësi të kufizuara të folurit/të të shqiptuarit.

Ndërsa në teknikat që duhet të përdoren për personat me aftësi të kufizuara në intelekt janë të shprehura si kërkesa minimale:

- a) dhënia e kohës së nevojshme për të procesuar, kuptuar dhe reaguat;
- b) rimarrja dhe përsëritja e informacionit, shpjegimi i informacionit në gjuhë të thjeshtë, copëzimi i informacionit në koncepte më të thjeshtuara, pa e tepruar, dhënia e besimit dhe e sigurisë gjatë komunikimit;
- c) të dëgjuarit e vëmendshëm, mosndërprerja e panevojshme e ligjëratës, përdorimi i fjalive e i fjalëve të thjeshta në të shkruar;
- ç) përdorimi i figurave, fotove, ngjyrave në materiale të shtypura.

Në këtë pjesë përcaktohen detyrimet për institucionet që duhet t’i sigurojnë me përparësi këto teknika, duke ndjekur modelin e përcaktimit të institucioneve që duhet t’i zbatojnë detyrimet me përparësi sikurse për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Këto institucione në rastin e personave me aftësi të kufizuara të intelektit janë të përcaktuara si prioritare: institucione të shëndetësisë, mbrojtjes shoqërore, arsimit, punësimit, transportit e të kulturës.

Kapitulli III dhe i fundit i këtij vendimi përmban parashikimet në lidhje me monitorimin e këtij vendimi dhe procedurat e ankimit në rastet e moszbatimit të tij.

Institucion përgjegjës për monitorimin për zbatimin e këtij vendimi është Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Në rastet kur konstaton shkelje të këtij vendimi mund të marrë masa përkatëse sipas kompetencave të veta dhe duhet të njoftojë MMSR. MMSR nga ana tjetër për rastet e moszbatimit të rregullave të u kërkon subjekteve përkatëse të marrin masat e nevojshme dhe të korrigjojnë shkeljen brenda një afati, jo më shumë se ½ e afatit të parashikuar në planifikim. Plani duhet të miratohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi dhe 12 muaj nga data e miratimit të këtij plani duhet të fillojë realizimin progresiv të tij.

Moszbatimi i rregullave të vendosura në këtë vendim përbën shkak për dhënien e masave disiplinore për punonjësit përgjegjës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankesat për shkeljen e së drejtës për aksesueshmëri në shërbime publike mund të paraqiten nga çdokush apo çdo subjekt para ministrit të MMSR.

Ministri përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar, nëpërmjet sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, merr në shqyrtim ankesën dhe u kërkon organeve kompetente referuese marrjen e masave administrative, si dhe përgatitjen e një informacioni për Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Një nga aspektet më përforcuese të këtij vendimi është ndalesa e financimeve ose mbështetja financiare nga ana e shtetit apo enteve publike dhe jopublike/donatorëve për ndërtimin e një vepre, me qëllim ofrimin e shërbimit publik, nëse objekti nuk përmbush kërkesat në vendim.

Ky parashikim ka nevojë që të monitorohet në mënyrë të veçantë në të ardhmen për të parë nëse institucionet e kanë respektuar atë. Por nga ana tjetër, për ta bërë atë plotësisht të zbatueshëm, duhet një reflektim edhe në legjislacionin për prokurimet, pasi institucionet shtetërore kryesisht njohin dhe i referohen vetëm atij.


V. NIVELI I ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,, PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR MËNJANIMIN E PENGESAVE NË KOMUNIKIM DHE INFRASTRUKTURË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA“

Në këtë kapitull renditen rezultatet e përfuara të monitorimit të nivelit të zbatimit të VKM-së Nr. 1074. Rezultatet janë ndarë në dy grupe kryesore. Në të parin janë përmbledhur rezultatet mbi nivelin e zbatimit të VKM-së nga institucionet kryesore të përzgjedhura sipas fushëveprimit të VKM-së. Ndërsa në grupin e dytë, pasqyrohen rezultatet në lidhje me zbatimin e VKM-së Nr. 1074 të institucioneve qendrore kryesore të parashikuara në këtë vendim: MMSR, MAS, KQZ, MB, TV dhe Media.

V. 1 Zbatueshmëria nga institucionet e përfshira

Pjesa më e madhe e institucioneve është e ndërgjegjësuar në lidhje me ekzistencën e disa detyrimeve për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Nga 56 institucione të cilat janë intervistuar ose kanë plotësuar pyetësorët, të gjitha deklarojnë që kanë njohuri në lidhje me legjislacionin që adreson çështjet e aksesueshmërisë.

Një pjesë e mirë e institucioneve, pavarësisht mosnjohjes dhe moszbatimit të VKM-së Nr. 1074, kanë marrë disa masa për sigurimin e aksesueshmërisë në institucione, edhe pse këto masa në mendimin e tyre janë të pamjaftueshme. Të dhënat e përftuara nga institucionet flasin për një numër të lartë institucionesh të ndërgjegjësuar në lidhje me detyrimet e përgjithshme që kanë kundrejt komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Nga numri total i institucioneve pjesëmarrëse, rreth 80% (n= 45) prej tyre deklarojnë që kanë marrë ose janë duke marrë masa për sigurimin e aksesueshmërisë. Vetëm në një nga rastet këto masat ishin ndërmarrë në kuadër të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.




Grafiku 1. Masat për sigurimin aksesueshmërisë

Edhe pse nuk kanë realizuar detyrimet ligjore, të gjitha institucionet deklaruan që do të planifikojnë të marrin masa në të ardhmen për të garantuar në institucionet e tyre aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, në momentin që u vunë në dijeni për ekzistencën e VKM-së Nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Përfaqësuesit e institucioneve të kontaktuar, në pjesën më të madhe, rreth 87.5 % deklaruan (n= 49) që institucionet të cilat përfaqësojnë nuk plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose i plotësojnë në nivel shumë të ulët. Këtu duhet theksuar,


që të gjithë i referoheshin infrastrukturës fizike apo barierrave arkitektonike dhe në asnjë rast nuk iu referuan personave me aftësi të kufizuara në shikim, dëgjim dhe të folur, apo personave me aftësi të kufizuara në sferën intelektuale. Edhe në rastet e tjera, në 12, 5% (n= 7) ku u deklarua që kushtet plotësohen, institucionet i referohen personave me aftësi të kufizuara fizike.



Grafiku 2. Përqindja e institucioneve që nuk sigurojnë aksesueshmërinë


Në lidhje me përdorimin e formateve të përshtatura, të cilat janë të parashikuara në VKM-në Nr. 1074 siç janë: (1) formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar për personat me vështirësi në komunikim; (2) botimin në gjuhën Braille; (3) shkrim të zmadhuar; (4) format audio material; (5) përkthim në gjuhën shqipe të shenjave; vetëm në 41% (n= 23) institucionet pohuan që përdorin të paktën 1-2 nga ato, kryesisht formatin e thjeshtuar të informacionit (i cili në të gjitha rastet nuk ishte i posaçëm për personat me aftësi të kufizuara intelektuale), shkrimin e zmadhuar dhe audio. Megjithatë, duhet theksuar që këto ishin kryesisht institucione të cilat ofronin shërbime për personat me aftësi të kufizuara e për rrjedhojë sigurimi i formateve të tilla ishte i domosdoshëm. Ndërkaq, të gjitha institucionet e tjera të cilat ofrojnë shërbime për publikun e gjerë në asnjë rast nuk kishin marrë masa edhe për ofrimin e shërbimeve në formatet e përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Madje gjatë intervistave të zhvilluara rezultoi që këto mënyra të ofrimit të aksesueshmërisë nuk njihen nga institucionet. Ata nuk kanë njohuri në lidhje me formatet e përshtatura për shembull për të verbërit, sistemet audio, video, shkronja e zmadhuara, përkthimi i gjuhës së shenjave apo formatet për personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Disa prej tyre pohojnë që personat me aftësi të kufizuara rrallëherë shkojnë në këto institucione për të marrë shërbimet që ofrohen. Janë familjarët, kujdestarët apo përfaqësuesit e tyre që shkojnë në vend të tyre. Sipas disa prej tyre, rreth 25% (n= 14) kjo është arsyeja që ato nuk kanë realizuar këto përshtatje. Ndërsa pjesa tjetër pohon, që edhe pse nuk kanë pasur kërkesa apo persona

me aftësi të kufizuara, e njohin si detyrim ligjor që t'i sigurojnë ato. Megjithatë, duhet theksuar që në çdo rast, institucionet pohojnë që janë financat e kufizuara që kushtëzojnë garantimin e aksesueshmërisë.



Grafiku 3. Institucionet që ofrojnë formatet të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara të ndryshme

Të pyetur në lidhje me kuadrin ligjor specifik, të cilit ato i referoheshin për eliminimin e pengesave ose sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, vetëm në 12,5% (n= 7) raste institucionet përmendën VKM-në Nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Edhe në rastet kur u përmend, institucionet nuk japin informacion në lidhje me detyrimet që kishin bazuar në këtë vendim.




Grafiku 4. Institucionet që njohin VKM-në Nr. 1074

Një numër më i lartë institucionesh, rreth 21% (n= 12) përmendën „Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë“, ndërsa një numër shumë i vogël përmendën VKM Nr. 1503, “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, Statusin e Invalidit të Punës, Ligjin “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Të gjithë përfaqësuesit deklarojnë që e njohin legjislacionin, por të pyetur në lidhje me ligjet specifike që adresojnë çështjet e aksesueshmërisë, në pjesën dërrmuese, sikurse shihet nga të dhënat e përftuara, nuk janë në gjendje të përmendin ndonjë prej tyre apo të detajojnë detyrimet dhe përgjegjësitë. Institucionet në përgjithësi iu referuan legjislacionit specifik me të cilin ata punojnë në fushën dhe në përditshmërinë e tyre siç janë Ligji për Shërbimet Shoqërore“ dhe vendimet e miratuara në zbatim të tij, Ligji për Arsimin Parauniversitar, aktet nënligjore apo rregulloret e brendshme. Sikurse u përmend edhe më sipër, institucionet janë të ndërgjegjësuar për përgjegjësitë në mënyrë të përgjithshme por nuk njohin rolin dhe detyrimet konkretisht dhe specifikisht që ato kanë.

Institucionet deklarojnë që në asnjë nga seancat informuese apo trajnuese nuk kanë marrë trajnime të posaçme për sigurimin e aksesueshmërisë. Kjo renditet edhe si një nga arsyet e moszbatimit të VKM-së Nr. 1074, pra mungesa e specialistëve në fushën e aksesueshmërisë, sidomos duke iu referuar aftësive të kufizuara shqisore dhe intelektuale dhe formateve apo mënyrave të përshtatura për këto lloj aftësish të kufizuara.

Arsyet kryesore për mosrealizimin e aksesueshmërisë, përveç mosnjohjes së VKM-së institucionet i rendisin, si kombinim i tre faktorëve, ku kryesues është ai financiar, 60% (n= 28). Faktorë të tjerë listohen si më poshtë: (i) personat me aftësi të kufizuara nuk e kanë kërkuar 25% (n= 14); (ii) personat me aftësi të kufizuara e kanë kërkuar por nuk kemi njohuri teknike për t’i siguruar 21% (n= 12); (iii) ndërsa vetëm rreth 3% (n= 2) e tyre shprehen se është e pamundur për shkak të infrastrukturës.



Grafiku 5. Arsyet e mossigurimit të aksesueshmërisë

Siç shihet nga rezultatet e pyetësorëve, pjesa dërrmuese e institucioneve rendisin mungesën e mjeteve financiare si një faktor që nuk lejon zbatimin e kuadrit ligjor. Rreth 17% e institucioneve (n= 10) pranojnë që edhe në rastet kur kanë dërguar në planet e tyre buxhetore parashikime specifike për rampa apo ashensorë, ato nuk janë miratuar në nivelin qendror.

Për arsye të mosnjohjes së VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” nga 56 institucionet që u intervistuan ose plotësuan pyetësorët e dërguar, vetëm një institucion në nivel rajonal ka të miratuar planin e masave për zbatimin e kërkesave të kërkuara për aksesueshmërinë më një afat realizimi të vendosur, dy vite.

Siç rezulton nga intervistat e kryera institucionet ende nuk e kuptojnë termin „aksesueshmëri“ sipas kuptimit që i është dhënë asaj në KDPAK apo në VKM. Ky term ka një kuptim shumë të ngushtë, i cili kufizohet kryesisht në ndërtimin e rampës dhe sigurimin e ashensorit në institucionet e tyre.

Sakaq, edhe në lidhje me zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara të intelektit, gjatë komunikimit dhe informimit nëpërmjet teknologjisë së komunikimit dhe informimit on-line nuk ishin marrë masa në asnjë rast.

Në rastet kur institucionet kishin krijuar faqe interneti, nuk kishin marrë masa për t’i përshtatur ato për përdorimin e tyre edhe nga personat me aftësi të kufizuara, në 99% të rasteve (n= 55). Vetëm një institucion deklaroi përdorimin e shkrimit të zmadhuar A+.

Në lidhje me transportin e përshtatur, për të cilin përgjegjës janë njësitë vendore, ato deklarojnë që janë vetëm pjesërisht të përshtatura dhe kryesisht për personat me aftësi të kufizuara fizike. Në asnjë nga rastet nuk është afishuar orari i lëvizjes së transportit të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara dhe nuk është siguruar lëvizja e mjeteve të përshtatura, transport ndërqytetas të paktën një herë në ditë sikurse parashikon VKM-ja. Këtu rikujtojmë që VKM-ja nuk njihet nga pjesa dërrmuese e institucioneve, dhe as nga bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës.

Të pyetur në lidhje me procesin e prokurimit, nëse përfshijnë masa për përshtatshmëri në kuadër të specifikimeve teknike, si një nga kushtet e detyrueshme për t’u plotësuar në një proces prokurimi, në të gjitha rastet institucionet deklarojnë që nuk parashikojnë të tilla kritere. Vetëm 3% (n=2) e institucioneve deklarojnë parashikimin e këtyre kritereve përsa i përket ndërtimeve të reja. Rikujtojmë që ky detyrim vjen si detyrim në kuadër të VKM-së Nr. 1503 që nga viti 2008.

V. 2 Zbatueshmëria nga institucionet qendrore

ISHPSHSH është një ndër institucionet që nuk kishte dijeni mbi miratimin e VKM- së Nr. 1074. Edhe pse në kompetencat e Inspektoriatit është që të monitorojë zbatimin e këtij vendimi, ai nuk e njihje këtë përgjegjësi që i ishte caktuar. ISHPSHSH monitoron shërbimet shoqërore dhe aksesueshmërinë e ka vlerësuar gjithmonë vetëm nga perspektiva e

standardeve të shërbimeve shoqërore për personat me aftësi të kufizuara, të cilat parashikojnë disa elemente të aksesueshmërisë. Gjatë intervistimit u deklarua nga përfaqësuesit e inspektoriatit që sidomos kohët e fundit gjatë inspektimeve të ndërmarra, është lënë si pjesë e sugjerimeve apo rekomandimeve edhe përshtatja e objekteve, por edhe në këtë rast është mbajtur në vëmendje kryesisht infrastruktura fizike duke u kufizuar te rampa apo ashensori. Inspektorati, pasi u njoh me këtë vendim, përmes titullares mori përsipër që të fillonte nga muaji shtator përgatitjen e planit të parashikuar dhe marrjen e masave për të filluar zbatimin e përgjegjësive që i janë caktuar, monitorimin e vendimit.

Një hap pozitiv i vënë re, i cili ndikon në rritjen e zbatueshmërisë së VKM-së Nr. 1074, është ai i ndryshimeve të fundit ligjore (Ligji Nr. 57/2017) në Ligjin 9634, datë 30.10.2006 „Për inspektimin e punës“, në të cilat është përfshirë detyrimi për inspektimin e elementeve të aksesueshmërisë sipas Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e PAK, duke përfshirë edhe vendimin nr. 1074.

MMSR, një institucion kyç, institucion i cili ka propozuar vendimin, i cili u miratua, nuk ka filluar ende nga zbatimi i VKM-së Nr. 1074. MMSR ende nuk ka një plan për aksesueshmërinë edhe pse për institucionet e varësisë apo të tjera janë dhënë rekomandime nga MMSR.

Në vijim paraqiten të dhënat e përfuara nga formulari i plotësuar dhe nga intervistimet me përfaqësues të MMSR.

Në përgjigjet e tyre, përfaqësuesit e MMSR të pyetur në lidhje me hartimin e një plani, përmenden Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, miratuar me VKM nr 389, Dt.29.06.2016 që përmban një kapitull të veçantë për aksesueshmërinë, bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK". Ndër masat e marra prej tyre (jo në kuadër të VKM 1074) përmenden disa ndërhyrje në përshtatshmëri në ndërtesën e MMSR për sa u përket personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë MMSR ka shpërndarë kërkesat e vendosura nga VKM-ja Nr. 1074, në institucioneve të varësisë, vetë nuk ka hartuar planin e aksesueshmërisë.

Të pyetur në lidhje me zyrtarizimin dhe publikimin e kodit të gjuhës Braille, sikurse parashikohet në VKM-në Nr. 1074 ku qartazi përcakton MMSR si përgjegjëse: „Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar zyrtarizon dhe publikon, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, kodin e gjuhës braille“, MMSR nuk e ka realizuar këtë detyrim.

Në lidhje me detyrimin për të identifikuar derimëtani nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimin të gjuhës së shenjave shqipe nga MMSR marrim informacionin që ekziston një grup ndërsektorial i punës për gjuhën e shenjave dhe që „MAS dhe MMSR kanë evidentuar nevojat në bazë të të dhënave të INSTAT“. Megjithatë, të pyetur në lidhje me rezultatet kryesore të identifikimit, nuk u dha informacion. Në këtë kuadër „do të realizohet një marrëveshje me MAS, MMSR dhe ANAD në të cilën do të parashikohet çështja e interpretëve dhe instruktorëve“.

Në lidhje me detyrimin për të zyrtarizuar dhe publikuar Fjalorin e Gjuhës së Shenjave Shqipe, MMSR nuk ka marrë masa për ta zbatuar atë. Ky detyrim duhej të përmbushej brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

Në lidhje me detyrimin për të përgatitur, botuar dhe shpërndarë udhëzues ose manual për punonjësit e institucioneve të shërbimeve publike për mënyrat e komunikimit dhe informimit të personave me aftësi të kufizuara të intelektit, MMSR nuk ka marrë masa për zbatimin e tij.

Në lidhje me pyetjen nëse janë marrë masa për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara të intelektit, gjatë komunikimit dhe informimit nëpërmjet teknologjisë së komunikimit dhe informimit on-line, sipas përcaktimit në VKM Nr. 1074, MMSR nuk dha informacion.

Në lidhje me marrjen në shqyrtim të ankesave për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015, MMSR përgjigjet që ka ankesa për aksesueshmërinë por jo të argumentuara në bazë të VKM-së Nr. 1074, por nuk përgjigjet në lidhje me numrin e tyre.

Përgjigja e MMSR në lidhje me ankesat, nëse i ka dërguar ky institucion përgjegjës ndonjë organi kërkesë për marrjen e masave administrative për ankesat e bëra, siç parashikohet në vendim është si vijon: “MMSR komunikon rregullisht me MZHU dhe institucionet përgjegjëse dhe me bashkitë për të theksuar zbatimin e legjislacionit duke përfshirë VKM Nr. 1503, VKM Nr. 1074 e masat strategjike për përshtatshmërinë. MMSR po punon me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për të mundësuar kontroll më të mirë për të targetuar ankesat.” Megjithatë, ISHPSHSH sikurse u theksua më lart nuk kishte dijeni për ekzistencën e vendimit. Në përgjigje nuk shohim të reflektuar KKAK, si një organ i cili është përfshirë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procedurat e ankimimit për shkeljet e së drejtës për aksesueshmëri.

Të pyetur më tej për rastet e moszbatimit të rregullave të parashikuara në VKM-në Nr. 1074, datë 23.12.2015 nga institucionet e parashikuara në vendim, nëse i është kërkuar subjekteve përkatëse të marrin masat e nevojshme dhe të korrigjojnë shkeljen brenda një afati, jo më shumë se ½ e afatit të parashikuar në planifikim, sikurse parashikohet në VKM-në Nr. 1074, MMSR kthen përgjigjen që subjektet përkatëse janë kontaktuar dhe janë përgjigjur se do të marrin masa në mënyrë progresive. MMSR ka theksuar afatet dhe rëndësinë e aksesit në institucionet publike në përgjigjet e dhëna.

Ndërkohë, duke iu referuar Planit të Veprimit 2016-2020, deri në fund të vitit 2016 duhej të ishte publikuar raporti i kontrollit të aksesueshmërisë nga MMSR, i cili rezulton deri tani i përcaktuar.

KQZ nga ana tjetër ka ndërmarrë disa masa në lidhje me zgjedhjet, për t'i bërë ato sa më të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, duke u bazuar në legjislacionin e posaçëm zgjedhor. Këto veprime nuk janë ndërmarrë në zbatim të VKM-së Nr. 1074.

MB, përmes përfaqësuesit të saj përgjigjet që nuk siguron aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara dhe nuk ka hartuar apo miratuar ndonjë plan për të. Megjithatë, përfaqësuesi i MB deklaron që për shkak të punësimit të një personi të verbër ata kanë marrë

disa masa për t'i siguruar atij aksesin e nevojshëm në ambjentet e ministrisë, duke u realizuar një rampë dhe sistemin NVDA (system që instalohet falas për leximin nga kompjuteri). Nuk ka informacion nëse forcat e rendit janë pajisur me njohuri bazë për sinjalistikën me audio dhe forma të tjera të përshtatura për lëvizshmërinë e pavarur të njerëzve të verbër, njohjen e shkopit të bardhë, gjuhës braille dhe shenjave të tjera dalluese, si mjete identifikuese të individëve të verbër, sikurse parashikohet në vendim.

Ndërsa nga monitorimi i televizioneve kombëtare apo në Media, u vërejt që ediconet kryesore të lajmeve nuk transmetohen të shoqëruar me titra apo me gjuhën e shenjave.

MAS nuk jep informacion në lidhje me realizimin e detyrimeve në kuadër të këtij vendimi.

V. 3 Personat me aftësi të kufizuara dhe aksesueshmëria

Me qëllim përfitim të dhënave nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara në lidhje me perceptimet dhe njohuritë e tyre për VKM-në Nr. 1074, u realizua një fokus- grup prej 10 personash me aftësi të kufizuara, ndër të cilët gjysma ishin aktivistë për të drejtat e komunitetit. Asnjë nga personat pjesëmarrës nuk kishte njohuri për ekzistencën e VKM-së Nr. 1074, dhe rrjedhimisht të të gjitha mekanizmave dhe mjeteve ligjore që ofron ky vendim për sigurimin e aksesueshmërisë. Pjesëmarrësit u shprehën që aksesueshmëria është një sfidë e madhe në Shqipëri, por një sfidë e cila akoma nuk është marrë përsipër nga institucionet shqiptare. Barierrat me të cilat ata hasen vazhdojnë të ekzistojnë dhe nuk janë parë masa konkrete të ndërmarra nga institucionet për t'i eliminuar këto barierra ose pengesa. Personat me aftësi të kufizuara nuk e njohin Vendimin Nr. 1074, edhe pse njohin në mënyrë të përgjithshme Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Asnjë nga pjesëmarrësit nuk është ankuar në rrugë zyrtare për shkelje të së drejtës për aksesueshmëri. Arsyet kryesore kanë të bëjnë më humbjen e besimit në zgjidhjen e çështjeve në rrugë institucionale.

VI. KAPITULLI KONKLUZIONE & REKOMANDIME

VI. 1 Konkluzione

Sikurse u theksua në kapitujt paraardhës legjislacioni vendas në një nivel të kënaqshëm përputhet me standardet ndërkombëtare në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë. Mes institucioneve ka një nivel të rritur ndjeshëm të ndërgjegjësimit në lidhje me detyrimet, që ato kanë përkundëjt personave me aftësi të kufizuara për sigurimin e aksesueshmërisë. Ajo çka mbetet tej mase shqetësuese është një nivel i ulët i njohjes të legjislacionit, mekanizma shumë të dobët të monitorimit dhe mungesa e raportimit të shkeljeve së të drejtës për aksesueshmëri të personave me aftësi të kufizuara.

Nga ana tjetër, ky nivel i ulët njohjeje vërehet edhe në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk e njohin këtë vendim, e për pasojë të gjitha mekanizmat që ofron vendimi për adresimin dhe ndjekjen e shkeljeve të të drejtës së tyre për aksesueshmëri nuk shfrytëzohen edhe pse janë miratuar prej vitit 2015. U konstatua gjatë realizimit të fokus-

grupit që në asnjë rast personat nuk ishin ankuar për çështjet të aksesueshmërisë në rrugë institucionale. Megjithëse pjesëmarrësit në fokus- grup njihnin të drejtat e tyre në mënyrë të përgjithshme, VKM-ja Nr. 1074 nuk njihej.

Institucionet e kontaktuara në katër rajonet, me përjashtim të rasteve sporadike nuk e njohin VKM-në Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe rrjedhimisht detyrimet që përmban ky vendim për secilin prej tyre. Rikujtojmë që edhe në rastet kur përmendej vendimi, nuk njihej përmbajtja e tij.

Vetëm në një rast ishte zbatuar detyrimi ligjor për hartimih dhe miratimin e një plani për eliminimin e pengesave sipas VKM-së Nr. 1074.

Institucionet njohin në pjesën dërrmuese vetëm aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë punën e tyre. Edhe kur pyeten në lidhje me njohuritë që kanë për kuadrin ligjor që trajton aksesueshmërinë, ata përmendim ligjet e tyre specifike dhe në shumë pak raste KDPK dhe Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara apo VKM-në Nr. 1074. Këto rezultate nuk vijnë vetëm nga mungesa e trajnimeve apo promovimi i mjaftueshëm, por edhe nga një praktikë, sidomos të institucioneve vendore dhe rajonale, të cilat „presin“ gjithmonë nga institucionet qendrore për dërgimin e udhëzimeve dhe fondeve nga institucionet qendrore. Një pjesë e mirë e institucioneve vendore dhe rajonale deklarojnë që nuk ka një koordinim të mirë dhe shkëmbim informacioni, dy faktorë që sipas tyre janë themelore për zbatimin e legjislacionit, përfshirë VKM-në Nr. 1074.

Institucionet edhe pse pranojnë që njohin legjislacionin, njohja është e sipërfaqetë dhe e fragmentuar. Ka një kuptim shumë të kufizuar dhe sipërfaqësor të ligjeve dhe vendimeve që trajtojnë aksesueshmërinë. Institucionet njohin disa detyrime të përgjithshme, që kanë të bëjnë kryesisht me rampat dhe me ashensorët. Ata nuk njohin aspekte dhe elemente shumë të rëndësishme të aksesueshmërisë për lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara, të ndryshme nga aftësitë e kufizuara fizike.

Mjetet shumë të kufizuara financiare renditen si një nga problemet e para për mosrealizimin e aksesueshmërisë po hapave që duhen ndjekur në zbatim të VKM-së Nr. 1074 për sigurimin e saj. Përgjithësisht institucionet e kontaktuara janë të mendimit që nuk kanë realizuar aksesueshmërinë ose e kanë realizuar atë në mënyrë të pjesshme dhe pranojnë që akoma kanë shumë për të bërë në këtë drejtim. Shumë prej tyre mendojnë që përveç mjeteve financiare, mungojnë edhe teknicienë për zbatimin e aksesueshmërië.

Është për t'u vlerësuar që pjesa më e madhe e institucioneve ishte e ndërgjegjësuar për detyrimet dhe përgjegjësitë, pavarësisht përdorimit ose jo të shërbimeve të ofruara në institucione nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Shumë pak prej institucioneve pohuan se nuk e kishin realizuar aksesueshmërinë duke qënë se institucionet nuk vizitoheshin nga persona me aftësi të kufizuara e si rrjedhim nuk kishte pasur nevojë për ndërhyrje në këtë drejtim. Vihet re që, ndër këto institucione, janë ato që operojnë në fushën e financave, institucione kulturore, sektori privat, duke përfshirë dhe Media-n. Ato kanë informacion më

të paktë dhe nuk i kushtojnë vëmendje çështjeve të personave me aftësi të kufizuara, duke mos e parë si detyrim garantimin e aksesueshmërisë. Ndërkohë që institucionet në fushën e shërbimeve shoqërore, shëndetësisë, arsimit janë më të prirura për të njohur dhe zbatuar detyrimet.

Një nga detyrimet që vjen nga KDPAK për shtetin Shqiptar, që është sigurimi i trajnimeve për aksesueshmërinë në mënyrë specifike, nuk është zbatuar. Institucionet në asnjë rast nuk deklaruan që kishin marrë trajnime specifike për atë se si duhej të zbatonin legjislacionin e posaçëm për aksesueshmërinë. Pjesa më e madhe pohon që nuk ka specialistë të cilët mund të vlerësojnë dhe realizojnë planet e detyrueshme sipas VKM-së Nr. 1074.

Gjatë mbledhjes së informacioni u konstatua që është anashkaluar një hallkë shumë e rëndësishme e zbatimit të legjislacionit, që është ajo e promovimit të tij. Duke pasur parasysh faktin që aksesueshmëria në Shqipëri mbetet një sfidë e madhe dhe personat me aftësi të kufizuara hasen përditë me pengesa, do të kishte qënë e vlefshme që miratimi i ligjeve si ai për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë apo i VKM-së Nr. 1074 të shoqërohej me një fushatë të gjerë promovimi e të vijohej më pas me fushata intensive trajnimesh për stafet e institucioneve kryesore të parashikuara në këtë vendim. Miratimi i legjislacionit kaq të avancuar duhet domosdoshmërisht të shoqërohet me veprimtari thelbësore siç janë promovimi dhe trajnimet, për të siguruar zbatimin efektiv të tij.

Si pasojë e këtyre mungesave, vendimi nuk njihet dhe ai ka humbur qëllimin e vet parësor, që është të sigurojë fillësat e zbatimit të aksesueshmërisë për të gjitha institucionet dhe sektorët përmes përcaktimit të një procedure të qartë veprimesh.

Kështu, të gjitha institucionet janë gjetur të papërgatitura me miratimin e këtij vendimi dhe vazhdojnë të mbeten të tilla.

Në Planin e Veprimit 2016-2020 gjejmë një parashikim për kryerjen e trajnimeve në lidhje me aspekte të ndryshme të aksesueshmërisë deri në fund të vitit 2017. Kjo mbetet për t'u vlerësuar në faza të mëvonshme të monitorimit, pasi deri më tani, informacioni i marrë nga institucionet është që nuk ka të tilla trajnime. Në këtë plan gjejmë gjithashtu detyrimin për kryerjen e një kontrolli të aksesueshmërisë në të gjitha mjediset për të cilat MMSR është përgjegjëse dhe shfrytëzimi i tij për të zhvilluar një plan për përmirësimin e aksesueshmërisë deri në fund të vitit 2016, plan i cili rezultoi në përealizuar.

Nga ana tjetër problematik mbetet monitorimi i këtij vendimi, institucionet përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të VKM 1074 nuk e njohin e rrjedhimisht nuk kanë monitoruar deri tani ndonjë aspekt të tij, Monitorimi për zbatimin e aksesueshmërisë bëhet sipas ligjeve të tjera ekzistuese në mënyrë të pjesshme. Edhe këtu duhet theksuar, që monitorimi fokusohet në infrastrukturën fizike dhe jo në të gjitha elementet e aksesueshmërisë sikurse kërkohet nga VKM-ja Nr. 1074.

Dy institucione shumë të rëndësishme, siç janë MMSR dhe MAS, të cilat janë ngarkuar me parashikime të veçanta përpos atyre të përgjithshme, nuk kanë realizuar në mënyrë plotë dhe në nivel të kënaqshëm detyrimet e tyre që burojnë nga VKM-ja Nr. 1074.

VI.2 Rekomandime

Në vlerësim të situatës së konstatuar në lidhje me të gjitha aspektet që mbulon ky monitorim u përgatit një grup rekomandimesh me synim për mundësimin e zbatimit efektiv të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Ato janë si vijon:

Së pari rekomandohet ndërmarrja e një fushate gjithëpërfshirëse në lidhje me legjislacionin e miratuar gjatë vieve të fundit e sidomos VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Së dyti, pas përfundimit të fushatës ndërgjegjësoes ose paralelisht me të, rekomandohet që të ndërmerret një fushatë trajnimesh dhe aftësimi të punonjësve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit mbi aksesueshmërinë.

Së treti, rekomandohet për institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe adresimin e ankesave që të fillojnë sa më shpejt nga evidentimi i shkeljeve të rregullave për garantimin e aksesueshmërinë dhe referimin e tyre pra MMSR;

Së katërti, rekomandohet për MMSR dhe KKAK që të krijojnë forume apo sesione me tematika të veçanta, siç është aksesueshmëria në mënyrë periodike për vlerësimin e gjendjes dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve sipas kompetencave, të cilat janë²⁷:

- Vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërisë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, nxjerr udhëzime dhe jep rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;
- Analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;

Së pesti, rekomandohet që të zhvillohen sesione informuese dhe ndërgjegjësoese me dhe për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara për t'i pajisur ata me njohuritë e nevojshme mbi legjislacionin e aksesueshmërisë, mekanizmat e monitorimit dhe procedurat e ankimit në rastet kur atyre mund t'i shkelet e drejta për aksesueshmëri.

Së gjashti, rekomandohet që komuniteti i personave me aftësi të kufizuara të përfshihet gjatë marrjes së masave për garantimin e aksesueshmëris, pasi kjo përfshirje do të sigurojë që masat janë brenda standardeve, përmes shkëmbimit të ekspertizës apo informacionit.

²⁷ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 21.1.2015 Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/7-2015.pdf

Së shtati, rekomandohet që institucionet qendrore dhe vendore të marrin masa serioze dhe të marrin përgjegjësitë e tyre në lidhje me caktimin e buxheteve për garantimin ose përmirësimin e aksesueshmërisë dhe të rrisin koordinimin mes tyre.

ANEKSI I

Lista e institucioneve të kontaktuara:

1. Kryeministria
2. Ministër i Integritimit Evropian
3. Ministër i Ekonomisë jo
4. Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës
5. Ministër i Zhvillimit Urban
6. Ministër i Punëve të Jashtme
7. Ministër i Punëve të Brendshme
8. Ministër i Mbrojtjes
9. Ministër i Drejtësisë
10. Ministër i Arsimit dhe Sportit
11. Ministër i Financave
12. Ministër i Kulturës
13. Ministër i Energjisë dhe Industrisë
14. Ministër i Shëndetësisë Jo pyetjeve.
15. Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratës
16. Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
17. Ministër i Mjedisit
18. Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
19. Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin
20. Ministër Shteti për Çështjet Vendore
21. Prokuroria e Përgjithshme
22. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë
23. Prokuroria e Rrethit Tiranë
24. Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë
25. Instituti i Shëndetit Publik Tiranë
26. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
27. Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë
28. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
29. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
30. Gjykata e Apelit Tiranë
31. Shërbimi Social Shtetëror
32. Qendra Pëllumbat
33. Bashkia Tiranë
34. Shërbimi Kombëtar i Punësimit
35. Zyra e Punës Tiranë
36. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Tiranë
37. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan
38. Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan
39. Spitali Rajonal Elbasan

40. Drejtoria Arsimore Elbasan
41. Qendra e Kulturës Elbasan
42. Qendra e Autizmit Elbasan
43. Bashkia Elbasan
44. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan
45. Media Lokale Elbasan intervistuar
46. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan
47. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan
48. Drejtoria e Shëndetit Publik Elbasan
49. Qendra Balash
50. Drejtoria Rajonale e Punësimit
51. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional
52. Drejtoria e Formimit Profesional Vlorë
53. Zyra e Punësimit
54. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
55. Bashkia Vlorë
56. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë
57. Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Vlorë
58. Gjykata e Apelit Vlorë
59. Shkolla për fëmijët me prapambetje mendore Vlorë
60. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë
61. Biznes Vlorë
62. Zyra Rajonale e punësimit Korçë
63. Qendra ditore- Atelie Korçë
64. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë
65. Drejtoria e Formimit Profesional Korçë
66. Bashkia Korçë
67. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë
68. Qendra e Kulturës Korçë
69. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë
70. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë
71. Spitali Rajonal Korçë
72. Drejtoria e Shëndetit Publik Korçë
73. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë
74. Biznes Korçë

REFERENCA

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25, pika c; 23 mars 1976
<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, neni 5, pika f, 4 Janar 1969
<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CERD.aspx>

Manual për aksesueshmërinë dhe standardet, ribotim, 2014, ISO, IEC

http://isotc.iso.org/livelink/livelink/fetch/2000/2122/4230450/8389141/ISO_IEC_Guide_71_2014%28E%29_Guide_for_addressing_accessibility_in_standards.pdf?nodeid=8387461&vernum=-2

Manual për adresimin e aksesueshmërisë përmes standardeve, edicion i robotuar, 2014, CEN-CENELEC

ftp://ftp.cencenelec.eu/EN/EuropeanStandardization/Guides/6_CENCLCGuide6.pdf

Manual për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Të kuptuarit e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, faqe 46, 47; Marianne Schulz, 2010.
http://www.hiproweb.org/uploads/tx_hidrtdocs/HICRPDManual2010.pdf

Rezoluta mbi Rregullat Standarde për Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara A/RES/48/96 miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, 4 March 1994
<http://www.un.org/disabilities/documents/gadocs/standardrules.pdf>

Indikatorët kryesore për aksesueshmërinë, KDPAK, The Global Alliance on Accessible Technologies and Environments (GAATES), Maj 2015.

http://gaates.org/wp-content/uploads/2014/07/FINAL-Toolkit_-UN-CRPD-KEY-INDICATORS-OF-ACCESSIBILITY-2015-06-29.pdf

Raporti fillestar i Shtetit Shqiptar bazuar mbi nenin 35 të KDPAK, Maj 2015

http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fALB%2f1&Lang=en

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf

Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 22 Maj 2014

http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/2&Lang=en

Ligji Për përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara 24.07.2014 dhe i botuar ne Fletoren Zyrtare numër 135, më datë 28 Gusht 2014

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/243.pdf

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 21.1.2015 Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/7-2015.pdf